



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1998/Prot.

Tiranë, më 28.07.2025

VENDIM
Nr. 189, Datë 16.07.2025

“PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS TË KANDIDATIT PËR MAGJISTRAT PROKUROR, I CILI ËSHTË DIPLOMUAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS NË VITIN AKADEMIK 2024 - 2025, Z. BRUNO STËRMASI”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen plenare të datës 16.07.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit për magjistrat prokuror, i cili është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024 - 2025, z. Bruno Stërmasi”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1998, datë 15.07.2025, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, pasi dëgjoi relatorin Erind Merkuri si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, Këshilli) garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve.
2. Me Vendimin Nr. 24, datë. 13.02.2025, "*Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për magistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magistraturës në vitin 2025*", Këshilli ka filluar procedurën administrative për verifikimin e pasurisë dhe figurës për 26 (njëzetë e gjashtë) kandidatë prokurorë të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magistraturës, në vitin 2025, ndër të cilët edhe kandidati Bruno Stërmasi.
3. Me Vendimin nr.25, datë 13.02.2025, për "*Hedhjen e shortit dhe caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për 26 (njëzetë e gjashtë) kandidatët për magistratë prokurorë, të cilët mund të diplomohen nga Shkolla e Magistraturës në vitin akademik 2025*", Këshilli zhvilloi procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit, për secilin kandidat.
4. Në zbatim të pikës 1, të Seksionit A, të Kreut VI, të Rregullores, në rrugë elektronike (me e-mail), Relatori më datë 17.02.2025 ka njoftuar kandidaten për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e Relatorit apo ndonjë Anëtar të Këshillit, në rast të ekzistencës së një shtate konflikti interesi.
5. Në përgjigje, me e-mail-in e datës 19.02.2025, kandidati Bruno Stërmasi ka konfirmuar marrjen e e-mail-it të mësipërm, si dhe faktin që nuk ndodhet në shtatën e konfliktit të interesit me Relatorin.
6. Në datë 21.02.2025, Relatori ka dërguar me e-mail kandidatit formularët përkatës dhe autorizimin, me qëllim verifikimin nga ana e Këshillit të të dhënave që lidhen me pasurinë dhe figurën.
7. Në datë 27.02.2025, kandidati Bruno Stërmasi ka depozituar në protokollin e Këshillit dokumentet, si më poshtë vijon:
 - i. Autorizimi për Këshillin e Lartë të Prokurorisë me qëllim sigurimin dhe verifikimin e të dhënave personale;
 - ii. Deklaratë me të dhënat mbi adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike për njoftim gjatë kësaj procedure;
 - iii. Deklaratë mbi papajtueshmërinë me funksionin e magistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike;
 - iv. Deklaratë Individuale që kandidatja nuk është bashkëpunëtor, informator ose agent i shërbimeve sekrete;
 - v. Formular Vetë-deklarimi për zbatimin e Ligjit 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*".
8. Në mbështetje të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, germës "b", të Kreut II, dhe

Seksionit B, të Kreut VI, të Rregullores, Relatori ka ndjekur veprimet procedurale për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit Bruno Stërmasi.

9. Pas verifikimeve paraprake dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet përgjegjëse shtetërore, Relatori ka paraqitur para Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale Relacionin me *gjetjet* paraprake për kandidatin për t'u emëruar magjistrat, profili Prokuror, z. Bruno Stërmasi.

A. VERIFIKIMI I PASURISË SË KANDIDATIT

10. Me shkresën Nr.353 prot., datë 05.03.2025, Këshilli i është drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), për njoftimin për verifikimin e pasurisë për kandidatin për magjistrat, i cili do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2025.
11. Me shkresën Nr.513 prot., datë 05.03.2025, Këshilli i është drejtuar ILDKPKI për verifikimin e pasurisë për kandidatin për magjistrat, i cili do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2025.
12. Nga ana e këtij institucioni, është kthyer përgjigje me shkresën Nr. 97/23 prot., datë 30.06.2025. ILDKPKI ka paraqitur aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në sistemin e drejtësisë, për kandidatin për magjistrat, i cili do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës, z. Bruno Stërmasi.
13. Në këtë akt përfundimtar për subjektin deklarues z. Bruno Stërmasi theksohet, se: nga ILDKPKI është dërguar pranë Këshillit, Akti i kontrollit të plotë për Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë për **Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës** Nr. 809/25 prot., datë 06.10.2022.

Ky Akt-Kontrolli përfshin periudhën deri në datë 30.06.2022.

14. Në datë 08.03.2025, Bruno Stërmasi ka dorëzuar pranë ILDKPKI, Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë/ **që kandidon për t'u emëruar Magjistrat, profili Prokuror.**
15. Për kryerjen e kontrollit të plotë të kësaj deklarate, ILDKPKI ka krahasuar Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jo-bankar, të dorëzuar nga vetë kandidati, me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës së tyre, me nr. 97 prot., datë 11.03.2025, pranë institucioneve të ndryshme. **Ky kontroll është kryer për periudhën 01.07.2022-08.03.2025.**
16. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të

zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është konstatuar, se për kandidatin Bruno Stërmasi:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

17. Lidhur me shkresën Nr. 990/32 datë 30.06.2025 ILDKPKI në faqen 6 (gjashtë) Aktin Përfundimtar të Kontrollit të Plotë të Deklaratave të Interesave Private *Deklarimi i të ardhurave, ka konstatuar se;*

Gjithashtu në llogarinë bankare të deklaruesit nga Gjykata e rrethit gjyqësor Durrës, janë depozituar në total edhe 900.000 lekë, respektivisht me transaksionet e datës 10.03.2023; 11.04.2023 dhe 29.06.2023. Këto shuma nuk përbëjnë të ardhura për deklaruesin, por janë kthyer nga Gjykata me vendimet përkatëse, pasi deklaruesi në cilësinë e avokatit i ka paguar këto shuma për llogari të klientëve të tij. Duke qenë se deklaruesi e ka mbyllur aktivitetin si avokat në datën 29.09.2022, e ka pasur të pamundur të ndjek personalisht seancat gjyqësore. Për këtë arsye, seancat gjyqësore janë ndjekur nga babi i deklaruesit, në cilësinë e avokatit të zgjedhur me të njëjtën prokurë me deklaruesin. Për këtë shërbim, nga babi i deklaruesit janë lëshuar katër fatura të fiskalizuara, me nr.2, datë 29.10.2022; nr.4, datë 30.11.2022; nr.6, datë 20.12.2022 dhe nr.7, datë 20.12.2022, në shumën totale 900.000 lekë. Kjo shumë rezulton se i është kthyer deklaruesit nga gjykata dhe më pas deklaruesi e ka depozituar në llogarinë e babait të tij, vërtetuar sipas faturave të datës 27.04.2023 dhe 13.07.2023 të Credins Bank.

18. Si rezultat i konstatimit të mësipërm nga institucioni i ILDKPKI, Relatori me e-mailin e datës 10.07.2025 njoftoi subjektin e kontrollit me gjetjet dhe i vuri në dispozicion një kopje të Aktit të kontrollit.

19. Gjithashtu, bazuar në germën "b", të pikës 12, të Seksionit A, të Kreut IX, të Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019 "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve, Relatori në datën 10.07.2025, kërkoi me e-mail nga kandidati Bruno Stërmasi, që të depozitojë pranë zyrës së protokollit të Këshillit ose të përcjell të skanuara me e-mail, brenda 5 ditëve shpjegimet me shkrim si dhe dokumentacion mbështetës plotësues ose sqarues.

20. Kandidati, në datë 10.07.2025, dorëzoi nëpërmjet postës elektronike shpjegimet në lidhje me konstatimin e ILDKPKI, dhe vuri në dispozicion dokumentacionin përkatës duke parashtruar si vijon:

Unë Bruno Stërmasi kam ushtruar profesionin e avokatit nga data 04.01.2018 deri më 29.09.2022. Gjatë kësaj periudhe, si avokat kam paguar për klientë të ndryshëm në llogarinë bankare të gjykatës shuma në cilësinë e garancisë pasurore, e cila shërben si një nga masat e sigurimit personal, të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale.

Pas fillimit të Shkollës së Magjistraturës, unë kam ndërprerë ushtrimin e profesionit të avokatit dhe për këtë arsye, këto çështje janë ndjekur në gjykim nga babai im, Av. Avenir Stërmasi.

Në përfundim të këtyre gjykimeve, rezulton se gjykata ka disponuar me vendim për kthimin e shumave të paguara si garanci pasurore. Duke qenë se personi që ka paguar këto shuma kam qenë unë, sipas vendimeve përkatëse kthimi i garancisë është bërë në favorin tim.

Gjatë kësaj kohe, unë nuk kam ushtruar profesionin e avokatit dhe këto të ardhura nuk më përkasin mua, por babait tim, i cili ka lëshuar edhe faturat e fiskalizuara për çdo klient.

Në këto kushte, pasi këto të ardhura kanë kaluar në llogarinë time bankare, unë përfundimisht i kam kaluar në llogarinë bankare të babait tim, bashkë me përshkrimin përkatës për çdo faturë, te cilat i vuri në dispozicion si më poshtë;

- 1. Vendimet e gjykatës që kanë disponuar për kthimin e garancisë në favorin tim;*
- 2. Faturat e fiskalizuara që i përkasin çdo klienti sipas gjeneraliteteve;*
- 3. Dokumentacionin bankar që vërteton kalimin e të ardhurave në favor të babait tim, me përshkrimet përkatëse.*

21. Sa më sipër duke bërë krahasimin midis gjetjeve të ILDKPKI-se të pasqyruara në Aktin Përfundimtar të Kontrollit të Plotë të Deklaratave të Interesave Private të subjektit Bruno Stërmasi si dhe me sqarimin e bërë dhe aktet e vëna në dispozicion nga kandidati Bruno Stërmasi rezulton se konstatimet e adresuara nga ILDKPKI për këtë subjekt kanë të bëjnë vetëm me vendimin e gjykatës ku ka disponuar me vendim për kthimin e shumave të paguara si garanci pasurore. Konkretisht në këtë rast bëhet fjalë për:

- Vendimin nr. (11-2022-5218) 659, datë 28.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku në pikën 4 të dispozitivit, citohet “Në bazë të nenit 236 të K.Pr.Penale, garancia, pasurore e depozituar në emër të të pandehurit në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë, për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, t’i kthehet depozituesit të saj Av.Bruno Stërmasi”, e shoqëruar me faturën nr.2, datë 29.10.2022, lëshuar nga Avenir Stërmasi, si edhe mandati bankar i Credins Bank, datë 27.4.2023.*
- Vendimin nr. (11-2022-5921) 775, datë 25.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku në pikën 4 të dispozitivit, citohet “Në bazë të nenit 261 të K.Pr.Penal, të konstatohet shuarja e masës së sigurimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke vendosur kthimin e shumës prej 200.000 lekë, depozituesit që ka kryer derdhjen e garancisë pasurore për Ibrahim Boran e konkretisht Av.Bruno Stërmasi”, e shoqëruar me faturën nr.4, datë 30.11.2022, lëshuar nga Avenir Stërmasi, si edhe mandati bankar i Credins Bank, datë 27.4.2023.*
- Vendimin nr. (11-2023-1013) 156, datë 02.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku në pikën 4 të dispozitivit, citohet “Urdhërohet kthimi i shumës depozituesit që ka kryer derdhjen e garancisë pasurore për Hamza Kizilay dhe Fuat Aytemur;*

konkretisht Av. Bruno Stërmasi”, e shoqëruar me faturën nr.7, datë 20.12.2022, lëshuar nga Avenir Stërmasi, si edhe mandati bankar i Credins Bank, datë 13.7.2023.

22. Nga sa më sipër, rezultojnë që shumat e qarkulluara në llogarinë e kandidatit, janë shuma që janë vendosur garanci pasurore (si një nga format e masave të sigurimit) nga ana e tij kur prej tij është ushtruar profesioni i avokatit. Këto shuma vetëm atij mund t'i ktheheshin sipas dispozitivit të gjykatës, por që për shkak të procedurave gjyqësore, rezulton që ato kanë përfunduar, mbas kandidati kishte filluar studimet pranë Shkollës së Magjistraturës.
23. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me veprimtari avokatie të ushtruar gjatë kohës që ndiqte studimet pranë Shkollës së Magjistraturës, por janë pasojë e veprimeve më të hershme në kohë.
24. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Agjencia e Inteligjencës Financiare i është drejtuar Këshillit ku informon, se: **“Pas kërkimeve në sistemin elektronik, për kandidatin Bruno Stërmasi disponohen raportime në bazë të cilave Relatori vlerësoi se, nuk përbëjnë shkak për ndalim të kandidatit dhe janë në përputhshmëri me gjetjet e aktit të kontrollit të administruar në Këshilli nga ILDKPKI për Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë e cila është sqaruar më lart.**
25. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën Nr. 1803 prot., datë 21.03.2025, ka kthyer përgjigje se: **Shtetasi Bruno Stërmasi nuk figuron i regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.**
26. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën Nr.5233/1, datë 25.03.2025 ka informuar, se: nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik të administrimit të të dhënave “Asycuda World” **rezulton, se shtetasi Bruno Stërmasi nuk ka kryer asnjë procedurë doganore.**
- Sa lidhet me informacionin për para CASH, çek apo metale a sende të çmuara në pikat e kalimit kufitar doganor, nuk rezulton të ketë kryer veprime të tilla, për periudhën Mars 2004 - Mars 2025.
27. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën Nr. 2944/1 prot., datë 19.03.2025 të ISSH, është dërguar informacion më të dhënat e nxjerra nga sistemi informatikë i ISSH, i cili disponon të dhëna për kontributet, të cilat mblidhen dhe dërgohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Web-service, sipas formularit bashkëlidhur të dërguar. Sipas këtij formulari rezulton, se: **“Për shtetasin Bruno Stërmasi janë paguar rregullisht pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, nga viti 2012 deri më shtator 2022”.**
28. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Qendra Kombëtare e Biznesit me shkresën Nr. 5115/1 prot., datë 13.03.2025 ka informuar, se: **shtetasi Bruno Stërmasi figuron i regjistruar si person fizik me emër Bruno Stërmasi, pajisur me NUIS (NIPT), L81304508G. Statusi i subjektit është “Çregjistruar”.**

29. Nga përgjigjet e ardhura nga këto institucione arrijmë në përfundimin, se: ka rezultuar përputhshmëri mes deklarimeve të kandidatit të kontrolluar, Aktit të përgatitur nga ILDKPKI-ja, si dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet e mësipërme. Në këtë mënyrë, është konkluduar, se nuk ka nevojë të kryhet një hetim më i thelluar, se ai i kryer nga ILDKPKI.

B. VERIFIKIMI I FIGURËS SË KANDIDATIT

30. Mbi bazën e Formularit të vetë-deklarimit për zbatimin e Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kandidati Bruno Stërmasi deklaroi, se:

- nuk ka qenë i dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;
- nuk është i dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo-përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- nuk ka qenë ndonjëherë nën hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një veprë penale;
- nuk ka qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj-zbatuese, për kryerjen e një veprë penale;
- nuk është caktuar ndaj tij ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo;
- nuk është lëshuar ndonjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar, lidhur me kryerjen e veprave penale;
- nuk është marrë ndaj tij masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- nuk ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 (një) muaj.

31. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën Nr. 392/3, datë 20.03.2025, Prokuroria e Përgjithshme informon, si më poshtë:

Nga verifikimet në Sekretarinë Sekrete në zyrën e arkiv protokollit në Prokurorinë e Përgjithshme rezultoi, se: **Nga verifikimet në sektorin e Burimeve Njerëzore, Marrëdhëniet me Publikun dhe Arkivit Sekret, rezultoi se nuk ka çështje penale, kallëzim apo ankesë ndaj tij.**

32. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me shkresën Nr.9671, datë 20.03.2025, informon, se: **"Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të këtij prokurorie, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të shtetasit Bruno Stërmasi, nga data 30.06.2022 deri aktualisht."**

33. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm: Berat, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, Elbasan, informojnë, se: **"Për shtetasin Bruno Stërmasi nuk disponojnë të dhëna, apo indicie të ardhura nga agjencitë ligj-zbatuese, të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm apo materiale kallëzuese të mosfilluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim".**

34. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën Nr. 1055, date 01.04.2025 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar konfirmon, se pas verifikimeve të kryera në regjistrat përkatës nga sekretaria gjyqësore, **rezulton se në lidhje me shtetasin Bruno Stërmasi nuk rezulton të ketë proces gjyqësor penal pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe kjo gjykatë nuk ka dhënë vendim penal për këtë kandidat.**
35. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën Nr. 4641/1, datë 17.03.2025 konfirmon, se pas verifikimeve të kryera në regjistrat që disponojnë, në lidhje me shtetasin **Bruno Stërmasi nuk rezulton të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal. Ndaj tij nuk është marrë vendim për të zbatuar/revokuar/shuar një masë sigurimi me karakter personal ose pasuror. Nuk ka të dhëna për procedime penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara, vendime dënime apo pafajësie në të cilat përmendet emri i kandidatit në proces verifikimi.**
36. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me shkresën Nr. 5679/1 datë 13.03.2025 informon, se **“Pas verifikimeve të kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) në lidhje me shtetasin Bruno Stërmasi, nuk rezulton të ketë pasur apo të ketë çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershëm.”**
37. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykatat pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm; Berat, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, Elbasan, informojnë, se: **“Për shtetasin Bruno Stërmasi nuk rezulton të ketë pasur apo të ketë në ngarkim të tij çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershëm.”**

Raportimi nga organet e specializuara

38. Gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidatin Bruno Stërmasi iu kërkuar informacion shërbimeve informative shtetërore, si Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencia Mbikëqyrjes Policore dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
39. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, kanë kthyer përgjigje me shkresat përkatëse të klasifikuara, ku është konstatuar se gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidatin Bruno Stërmasi:
- *Nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme;*
 - *Nuk ka të dhëna për veprimtari kriminale apo të ketë lidhje/kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;*
 - *Nuk disponohen të dhëna/informacione për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.*
40. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me Shkresën nr. 2127 prot, datë 15.04.2025, ka informuar, se: **“nuk**

disponohen të dhëna për përfshirjen e z. Bruno Stërmasi në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme”.

41. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Byroja Kombëtare e Hetimit me shkresën Nr. 405/1 prot, datë 28.03.2025, ka informuar, se: **“Nuk disponohen informacion dhe të dhëna për kandidatin Bruno Stërmasi”**.

42. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Shkolla e Magjistraturës me shkresën Nr. 371/1 prot., datë 18.03.2025, informon se: **“Kandidati Bruno Stërmasi nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe ndaj tij nuk ka ndonjë proces disiplinor”**.

43. Referuar Deklaratës, datë 25.02.2025, mbi papajtueshmërinë me funksionin e magjistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike, kandidati Bruno Stërmasi ka deklaruar se: nuk është anëtar në ndonjë parti politike, pasi kjo përbën shkak papajtueshmërie me funksionin e magjistratit. Kjo deklaratë është lëshuar me përgjegjësi ligjore sipas nenit 6, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sipas Deklaratës Individuale datë 27.02.2025, kandidati ka deklaruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete.

44. Për shkak të datëlindjes së kandidatit, Këshilli nuk i është drejtuar me shkresë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi kandidati nuk është subjekt verifikimi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

45. Përsa më sipër rezulton se, nga përgjigjet e ardhura nga institucionet e sipërcituara rezulton se, për kandidaten Bruno Stërmasi **nuk disponohen të dhëna dhe informacione për përfshirje në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitetet të kundërligjshme**.

46. Përsa më sipër, Këshilli vlerëson të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit për magjistrat prokuror, e cila është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024-2025, z. Bruno Stërmasi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 32 dhe 35, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 159 dhe 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 171, datë 29.09.2019, “Për miratimin e “Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit

të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale sipas Relacionit nr. 1998, datë 15.07.2025, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për magjistrat prokuror, i cili është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024-2025, z. Bruno Stërmasi.
2. Lejimin e kandidatit Bruno Stërmasi, të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e tij si prokuror.
3. Të njoftohet për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës dhe z. Bruno Stërmasi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 16.07.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla